



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 10575 prot.

Shkodër, më 06.05. 2026

VENDIM

Nr. 35, datë 30.04.2026

**PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË SHKODËR, SË BASHKU ME
DOKUMENTACIONIN TEKNIKO-LIGJOR PËR AKORDIMIN E NDIHMËS
FINANCIARE PËR FAMILJEN E SHPRESA DHAMCA, BANESA E TË CILËS ËSHTË
DËMTUAR NGA ZJARRI**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 30.04.2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, bazuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligjin nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”; Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar; VKM-në nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”; VKM-në nr. 414, datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, i ndryshuar; VKB-në nr. 84, datë 18.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026–2028 të Bashkisë së Shkodrës”, i ndryshuar, dhe dokumentacionin e përgatitur nga administrata e bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për ndihmën e menjëhershme financiare të familjes së Shpresa Dhamca, me 1 anëtar familjeje, në vlerën prej 20 000 (njëzet mijë) lekë, sipas certifikatës familjare të paraqitur, për dëmtimin e banesës së saj nga zjarri.
2. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër për familjen e Shpresa Dhamca, në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore prej 484 695 (katërqind e tetëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë dhe për dëmet në orendi prej 218 000 (dyqind e tetëmbëdhjetë mijë) lekë, sipas preventivave të Komisionit të Vlerësimit të Dëmeve pranë Bashkisë Shkodër.

3. Burimi i financimit të jetë fondi i emergjencave civile, parashikuar në programin AB141 “Siguria Publike dhe Mbrojtja Civile”, në buxhetin e Bashkisë Shkodër për vitin 2026, të miratuar me VKB-në nr. 84, datë 18.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026–2028 të Bashkisë së Shkodrës”, i ndryshuar, në programin AB141, Q2 O1 A5 “Përballimi i ndihmave të menjëhershme për familjet me raste fatkeqësie”, në vlerën 20 000 (njëzet mijë) lekë. Ngarkohet administrata e Bashkisë Shkodër për likuidimin e ndihmës së menjëhershme.
4. Për familjen e Shpresa Dhamca, kompensimi i dëmeve materiale ndërtimore dhe në orendi e pajisje do të bëhet sipas preventivave të vlerësimit, hartuar nga grupi i verifikimit dhe vlerësimit, në zbatim të Ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, neni 41; VKM-së nr. 329, datë 16.05.2012, pika 3; dhe VKM-së nr. 414, datë 08.07.2021, pika 3.1/a “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, sipas relacionit bashkëngjitur, në masën 50% të vlerës ndërtimore, në shumën 242 348 (dyqind e dyzet e dy mijë e treqind e dyzet e tetë) lekë, dhe në masën 50% të vlerës së orendive, në shumën 109 000 (njëqind e nëntë mijë) lekë, pas akordimit të fondeve nga Ministria e Mbrojtjes, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

Miratuar me 35 vota

Vota Pro	35
Vota Kundër	0
Vota Abstenim	0
Zbardhur me datë	04.05.2026

SEKRETARE

Sabina Danaj

